# DËSHMI ARKIVI

**A-469186**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës |
| ADRESA | `https://lapsi.al/rama-shba-tradhtoi-hashim-thacin-george-washingtonin-e-kosoves-i1094458` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:26:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:25:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `74f150a748a1f75287d1df890c96876d6a6fde66bfbc2566ec945c0061b5896b` |
| TEKSTI | `1929f3732c86a223d618e4898066b8ae1dfbcc8bf3df56f2120a82f459623fe8` |
| PAMJA | `ff5d981c342aee91f25127d420ba68c28d86b7013a2854262bb943ab57a83b0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d277c6da6fbb726824cff9026fccc0045b5b6e6f259c95ed4fcfb4489712ac02` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d277c6da6fbb726824cff9026fccc0045b5b6e6f259c95ed4fcfb4489712ac02`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

LAPSI.AL • 25 SEPTEMBER 2026



Kryeministri Edi Rama ka kritikuar Shtetet e Bashkuara për mënyrën se si është trajtuar ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke deklaruar se ai është "tradhtuar" nga vendi që e kishte mbështetur Kosovën gjatë luftës.

Gjatë fjalës së tij në Këshillin për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane në New York, Rama tha se Thaçi nuk ndodhet aty për shkak të asaj që ai e cilësoi si një "farsë" që, sipas tij, nuk duhej të kishte nisur.

"Thaçi nuk është sot këtu sepse ky vend e tradhtoi. Sepse edhe pse gjenerali Clark dhe miq të shkëlqyer bënë më të mirën, ky vend nuk bëri më të mirën për George Washingtonin e Kosovës", u shpreh Rama referuar asaj që ndodhi në Hagë në Gjykatën Speciale.

Kryeministri sqaroi se me termin "tradhtuar" nuk nënkuptonte se shqiptarët janë të barabartë në peshë me Shtetet e Bashkuara, por se marrëdhënia e gjatë mes shqiptarëve dhe SHBA-së e bën atë të ndihet i zhgënjyer nga mënyra se si është trajtuar çështja e Thaçit.

"Askush nuk duhet të më keqkuptojë sepse kur them tradhtuar e kam fjalën që jemi të gjithë shumë të vegjël dhe së bashku nuk jemi të mëdhenj. Por kemi kremtuar gjithmonë faktin që si shqiptarë jemi miq me SHBA, me më të mëdhenjtë e më të fortët, ndaj ndihem i tradhtuar", tha Rama.

Ai shtoi se, sipas tij, Shtetet e Bashkuara mund të kishin bërë më shumë për të mos lejuar nisjen e procesit gjyqësor ndaj ish-presidentit të Kosovës dhe ish-krerëve të UÇK-së.

## ide



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku

MOTI TIRANA 18°c | KËMBIMI EURO 91.97

## aktuale

08:49
**Rama në OKB, në fokus Bordi i Paqes dhe çështja e ish-krerëve të UÇK-së**

07:52

Rama sot në OKB, pritet fjalimi në Asamblenë e Përgjithshme



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



“Jam i sigurt që ky vend mund të bënte më shumë duke mos lejuar që kjo farsë të niste. Mirënjohës për gjithçka keni bërë në kapacitetin personal tuaj”, deklaroi Rama.

Thaçi u dënua më 16 shtator nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë me 25 vite burgim për përgjegjësi penale për krime lufte.

## Të këshilluara



### PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale: Shqipëria të ketë 100 bashki dhe 12 qarqe

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka depozituar sot zyrtarisht draft ligjin për ndarjen administrative-territoriale të njësive të...



### Ambasadori gjenaral amerikan mbërrin në Tiranë

Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, Eric Wendt, ka mbërritur në Tiranë, ndërsa nesër pritet të zh...



### Vrasja e ‘Tanit të Rruzhdiut’ në Sarandë, dalin fotot e autorit në momentin e ekzekutimit



### Kthesa e fortë/ Euro fiton terren ndaj Lekut brenda javës

Kursi i këmbimit të Euros me Lekun e ka mbyllur javën në rritje. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, Euro...



### Këshilli Bashkiak fton Veliajn në mbledhje/ Kërkesë SPAK-ut për pjesëmarrjen

Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon pjesëmarrjen e kryebashkiakut Erion Veliaj në mbledhjen e 29 shtatorit, e parashikuar të zhvil...



### Këshilli Bashkiak fton Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-ut dhe Burgjeve për pjesëmarrjen




**Takime me agjentë serbë?/ Gazetarja Klodiana Lala flet për deklaratën e Vlora Hysenit**




Vlora Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala




Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...




"Krejt radarët i mbyll për ty"/ Mesazhet e tjera mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit



Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon pjesëmarrjen e kryebashkiakut Erion Veliaj në mbledhjen e 29 shtatorit, e parashikuar të zhvil...




## Parandalohet sherri mes 23 adoleshentëve në Yzberisht, sekuestrohen shkopinj bejsbolli




### Aksident në aksin Korçë-Qafë Plloçë, përplasen dy mjete, 3 të plagosur

Një aksident rrugor është regjistruar këtë të enjte në aksin Korçë-Qafë Plloçë, ku dy automjete...




### Plagosja e 31-vjeçarit në Lezhë/ Gjendet automjeti me të cilin u larguan autorët nga vendngjarja, babë e bir ende në kërkim

Policia ka dhënë deteja lidhur me plagosjen e ndodhur ditën e djeshme në fshatin Manati të Lezhës. Blutë bëjnë me ...



### Forcat suedeze dhe finlandeze zbulojnë avionët ushtarakë rusë mbi Gjirin e Finlandës

Forcat ajrore finlandeze thanë të premten se avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë ishin ngritur në ajër për t&e...

## Me sytë katër



23:13

PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për ne! Meta vetëm i ndizte

20:36





Deputeti i Partisë Socialiste Bledi Çuçi ka qenë "viktima" e radhës e protestuesve në Tiranë, të cilët i kan&e...

PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

22:43

PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

21:28

## SPORT

→ Të tjerë artikuj




15:58

### "Nuk mora tjetër se kam lojtarin e Serisë C": Maran habit me përgjigjen pas dëmtimit të Balliut




15:42

### "Kemi bërë një premtim": Gjimshiti tregon paktin e lojtarëve me teknikun Maran, para Bjellorusisë



12:45

### Ancelotti fyen Indinë e futbollit, trajneri i Kombëtares vendase diplomat: "Nuk më intereson"



12:04

### Transformimi i Gjermanisë nga Jurgen Klopp: bën një gjest me dorë dhe e gjithë skuadra bën presing




11:35

### Zinedine Zidane befasohet nga një gazetar: "Për mua është një ëndërr të jem këtu, a ma jepni një autograf?"



11:05

### Inter, shifra rekord: 518 milionë euro të ardhura, rezultati i dytë më i mirë në histori, e 22,7 milionë fitim



10:56

### Stekë bilardo apo pushkë? Lojtari i Izraelit Abu Farchi përjashtohet e pas polemikave sqaron festimin e tij

## PAPARAZZI



15:09

### Dove Cameron dhe Damiano David i japin fund beqarisë

Dove Cameron dhe Damiano David i kanë dhënë fund beqarisë! Aktorja e "Descendants", 30 vjeçe, dhe këngëtari i ...



"Askush nuk duhet të ketë kaq shumë pasuri", Kylie Jenner kritikohet për stilin e jetesës

20:39



Një dekadë pas martesës, zbulohet ndryshimi i papritur që bëri Margot Robbie

20:32



Selena Gomez dhe Benny Blanco drejt zgjerimit të familjes? Këngëtarja zbulon planet për të ardhmen

20:26



Lady Gaga bëhet nënë, ja emri i vajzës dhe historia e veçantë pas tij

19:37




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.